

SALI KADRIA

**KRYENGRITJA E MIRDITËS E VITIT 1921 DHE ÇËSHTJA
KOMBËTARE SHQIPTARE NË OPTIKËN E DIPLOMACISË
BRITANIKE**

Në fillim të vitit 1921, qeveria jugosllave vazhdonte presionin politik dhe ekonomik ndaj Shqipërisë. Përmes kësaj politike, ajo synonte të arrinte disa objektiva të rëndësishëm: ndryshimin ose të paktën “ndreqjen” e kufirit shqiptaro-jugosllav në favor të Mbretërisë Serbo-Kroato-Sllovene, largimin e plotë të trupave italianë nga Shqipëria si dhe detyrimin e qeverisë shqiptare që të pranonte një sistem doganor të përbashkët. Çështja e fundit, ishte një prej pikave kryesore të marrëveshjes së arritur më herët me Esat Pashën.

Gjatë periudhës së sundimit osman, krahina e Mirditës gëzonte të drejtën e vetadministrimit lokal dhe kishte në krye kapedanin e saj. Popullsia katolike gjendej nën mbrojtjen e Austro-Hungarisë. Gjatë punimeve të Kongresit të Berlinit, përfaqësuesi i Francës, William H. Waddington, kërkoi që t’i njihej e drejta e autonomisë administrative krahinës së Mirditës¹. Preng Bibë Doda ishte kapedan i Mirditës nga vitet ’70 të shek. XIX deri në vitin 1920. Meqenëse ai nuk la trashëgimtarë, kushëriri i tij, Gjon Marka Gjoni, zuri vendin e tij. Pas Kongresit të Lushnjës, në organet kushtetuese të dala prej këtij të fundit (Këshilli Kombëtar, Qeveria dhe Këshilli i Naltë) nuk pati përfaqësues mirditorë. Në pranverë të vitit 1921, një grup mirditorësh që kishte lidhje me familjen e kapedanit të Mirditës, i kërkoi Ministrisë së Punëve të Brendshme që t’u jepej leje të shkonin në Prizren për të blerë misër me çmim më të lirë. Ministri i Punëve të Brendshme refuzoi që t’u jepte lejen e kërkuar.

Më 25 prill 1921, Gjon Marka Gjoni dhe Zef Ndoci, në krye të 60 vetëve të pakënaqur nga refuzimi i qeverisë shqiptare, vendosën të

¹ *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1876 – 1879) (Dokumente arkivash franceze)*, vëll. I, përgatitur nga Ligor Mile, botim i Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave të RPS së Shqipërisë, Tiranë: “Mihal Duri”, 1978, dok. nr. 134, f. 184. Pons, drejtues i konsullatës së Francës në Shkodër, drejtuar W. Waddington, ministër i Punëve të Jashtme të Francës, Shkodër, më 2 gusht 1878.

shkonin pa leje në Prizren². Ata synonin që të negocionin me autoritetet jugosllave që të lejonte importimin e drithit për banorët e varfër të krahinës së Mirditës³. Mosmarrëveshjet e mirditorëve me qeverinë u shfrytëzuan nga qeveria jugosllave. Grupi i Marka Gjonit u prit me mjaft nderime nga autoritetet serbe në Prizren. Gjatë qëndrimit në territorin e shtetit jugosllav, Marka Gjoni arriti një marrëveshje me drejtuesit serbë, për të furnizuar me misër mirditorët, me një të tretën e çmimit që gjendej në treg. Marrëveshja e tij me autoritetet jugosllave, acaroi qeverinë shqiptare. Ajo u shqetësua nga vendosmëria e mirditorëve për të thyer urdhrin e saj si dhe nga fakti që qeveria jugosllave po tregohej kaq “dashmirëse” ndaj shqiptarëve katolikë. Për arsytet e lartpërmendura, qeveria shqiptare vendosi të mbyllte kufijtë, duke lënë mirditorët jashtë vendit.

Vizita e Gjon Marka Gjonit në Prizren, nuk kaloi pa dhënë “frytet e saj”. Në fillim të qershorit 1921, Marka Gjoni, në krye të një grupi mbështetësish u kthye në Mirditë, me qëllim që të organizonte banorët e krahinës së Mirditës kundër “Qeverisë së Tiranës”. Si pretekst për fillimin e “kryengritjes” u përdor teza, se qeveria shqiptare kishte shpërfillur banorët katolikë të Mirditës. Në mesin e mirditorëve qarkullonin fjalë, se kapedanit të Mirditës nuk i ishte dhënë ndonjë gradë ushtarake e shoqëruar me rrogë, siç ishte vepruar me të tjerë. Në fakt, kapedani i kishte kërkuar qeverisë që Mirditës t’i njiheshin privilegjet e saj. Ministri i Punëve të Brendshme, Mehdi Frashëri, nuk e pranoi këtë kërkesë. Ai ishte përgjigjur se privilegje të tilla i takonin periudhës kur Shqipëria ishte nën sundimin e huaj, por jo në një shtet kombëtar. Këto kërkesa nuk mund të pranoheshin, pasi konsideroheshin tradhti kombëtare⁴.

Shumica e mirditorëve u gënjye nga propaganda e përhapur, se qeveria e Tiranës synonte të kufizonte lirinë e besimit katolik në Mirditë. Në fund të qershorit 1921, Gjon Marka Gjoni mblodhi bajraktarët e Mirditës në Orosh. Megjithëse nuk kishte influencë të madhe në Mirditë, ai arriti të bënte për vete një grup prej 120 mbështetësish kryesisht nga paria e vendit, të cilëve u shpërndau një shumë të hollash me kusht që ata

² Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)*, (Kujtime dhe vlerësime historike), botim i dytë, Tiranë: “Neraida”, 2000, f. 246.

³ Paskal Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia (1918 – 1927)*, Tiranë: Shtëpia Botuese “Enciklopedike”, 1992, f. 130.

⁴ Mehdi Frashëri, *Kujtime – vitet 1913-1933*, Tiranë: OMSCA-1, 2005, f. 93.

ta mbështesnin me njerëz të armatosur. Synimi i tij, ishte të mblidhte rreth 1200 deri në 1500 burra⁵.

Në lidhje me shkakun e fillimit të kryengritjes në Mirditë ka dy këndvështrime të ndryshme: studiuesi britanik J. Swire shkruante se ministri i Brendshëm i Shqipërisë i kishte ofruar detyrën e nënprefektit të Mirditës, por Gjon Marka Gjoni kishte mbetur i pakënaqur nga oferta⁶. Pra, shkakun e fillimit të kryengritjes shihej te Marka Gjoni. Ndërkohë, Sejfi Vllamasi, Mihal Grameno dhe Eqrem bej Vlora mendonin se Mehdi Frashëri mbajti një qëndrim të gabuar. Ai i pati premtuar Marka Gjonit, detyrën e nënprefektit ose të oficerit rezervë me gradën major, por ai nuk e bëri këtë emërim. Sipas tyre, kërkesat e mirditorëve nuk duhej të shiheshin si “privilegje”, por masa të përkohshme politike, që të sigurohej mbështetja e banorëve të kësaj krahine, derisa të konsolidohej shteti shqiptar. Ata mendonin se shmangia e qeverisë nga ndjekja e një politike të urtë, që imponohej nga interesi kombëtar, nxiti lëvizjen kryengritëse të banorëve të Mirditës, e cila u përdor nga qeveria jugosllave⁷.

Drejtuesit e klerit katolik shqiptar u shqetësuan nga përpjekjet për organizimin e kryengritjes në Mirditë prej Gjon Marka Gjonit. Argjipeshkvi i Shkodrës, monsinjor Jak Serreqi i kërkoi Pal Dodës, famullitar i Rubikut, i cili gjendej në Itali që të kthehej sa më shpejt në Mirditë dhe të këshillonte kapedan Gjon Marka Gjonin, që të tërhiqej nga ky veprim i gabuar. Pal Doda organizoi një takim me parinë e vendit, ku i kërkoi që të hiqte dorë nga veprimet kryengritëse, pasi ato ishin në dëm të saj dhe të Shqipërisë. Pavarësisht këshillës së famullitarit, bajraktarët u shprehën se kishin dhënë fjalën dhe nuk mund ta thyenin atë. Në këto rrethana, Pal Doda i shkroi një letër Marka Gjonit, në të cilën i kërkoi të tërhiqej nga rruga e gabuar, pasi me këtë veprim, ai bënte lojën e armiqve të Shqipërisë. Me nxitjen e klerit katolik të Shkodrës, u formuan dy

⁵ *The British National Archives*, (më tej: TNA), Foreign Office (më tej: FO) 371/ 5728, H. C. A. Eyres për Earl Curzon të Kedleston, Durrës, më 7 korrik 1921.

⁶ Joseph Swire, *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie*, përkthyer nga Kujtim Ymeri, Tiranë: Dituria, 2005, f. 284.

⁷ “Njisija e Kombit”, në *Ora e Maleve*, nr. 37, Shkodër, 6 shtator 1924, f. 1; S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 245-246; Mihal Grameno, *Kryengritja Shqiptare*, Vlorë: Shtypshkronja G. Direttore, 1925, f. 174. Eqrem bej Vlora, *Kujtime (1885-1925)*, përkthyer nga Afrim Koçi, Tiranë: Shtëpia e Librit & Komunikimit, 2003, f. 474.

komisione: njëri me përfaqësues të parisë dhe tjetri me të rinj kombëtarë, të cilët shkuan në Mirditë, ku u përpoqën të këshillonin banorët që të ruanin qetësinë, pasi trazirat do të kishin pasoja të rënda për Mirditën dhe të gjithë Shqipërinë⁸.

Për shkak të mbështetjes jugosllave, qeveria shqiptare e kishte të qartë se kryengritja në Mirditë mund të merrte përmasa serioze. Për këtë arsye, kërkohet një veprim i shpejtë dhe i vendosur për të asgjësuar lëvizjen separatiste të Mirditës⁹. Fillimisht, qeveria shqiptare i dha përparësi përpjekjeve diplomatike. Më 7 korrik 1921, Fan Noli paraqiti në Lidhjen e Kombeve një protestë kundër Jugosllavisë për nxitjen e kryengritjes në Mirditë dhe pushtimin pa asnjë shkak nga ana e saj, të krahinës së Gashit dhe të Krasniqes. A. Zogu i propozoi qeverisë shqiptare se për zgjidhjen e çështjes së Mirditës, duhej të ndiqej njëra nga këto dy rrugë: të dërgohej një komision për të biseduar me parinë e Mirditës për të zgjidhur problemet në mënyrë paqësore, ose të dërgohej një forcë ushtarake prej të paktën 8 mijë vetësh për shtypjen e lëvizjes kryengritëse¹⁰. Për shmangien e përkeqësimit të situatës, qeveria shqiptare planifikoi dërgimin e një përfaqësie që të negocionte me bajraktarët e Mirditës për arritjen e një marrëveshje paqësore dhe vëllazërore¹¹. Një grup deputetësh propozuan që Bajram Curri dhe Luigj Gurakuqi të ndërmjetësonin me kryengritësit, me qëllim që të shmangej gjakderdhja. Mirëpo, qeveria shqiptare hoqi dorë nga ndërmjetësimi me kryengritësit, pasi gjykoj se kjo mënyrë veprimi dhe natyra e kryengritjes rrezikonte ekzistencën e shtetit kombëtar¹².

Me sa duket, qarqet politike serbe e konsideruan Gjon Marka Gjonin, si njeriun e duhur për të realizuar planet e tyre në Shqipëri. Përmes mbështetjes së kryengritjes së banorëve të Mirditës, qeveria jugosllave synonte realizimin e dy objektivave të rëndësishme. *Së pari*, nxitjen e përplasjes midis popullsisë katolike të krahinës së Mirditës dhe trupave të

⁸ S. Villamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 246-247.

⁹ P. Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia...*, f. 132.

¹⁰ TNA, FO 371/ 7332. H. C. A. Eyres për Earl Curzon të Kedleston, Durrës, më 1 maj 1922; Bernd Jurgen Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, përkthyer nga Krenar Hajdëri, Botim i tretë në shqip, Tiranë: Çabej, 2004, f. 40.

¹¹ TNA, FO 371/ 5727. H. C. A. Eyres për Earl Curzon të Kedleston, Durrës, më 16 qershor 1921.

¹² *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 152/3, Dosja (më tej: D) 13, fl. 175. Letër e një grupi deputetësh drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, datë 15 korrik 1921.

qeverisë shqiptare. Ndërhyrja e qeverisë serbo-kroate-slllovene në Mirditë do t'i shkaktonte vështirësi procesit të ndërtimit të shtetit kombëtar shqiptar. *Së dyti*, qeveria jugosllave synonte ta diskreditonte qeverinë shqiptare para Fuqive të Mëdha, të farkëtonte idenë te kancelaritë evropiane se fiset e Shqipërisë së Veriut nuk e njihnin qeverinë e Tiranës, por dëshironin një regjim autonom. Përmes kësaj strategjie, qeveria jugosllave do të arrinte aneksimin e të gjitha viseve veriore të Shqipërisë që gjendeshin të pushtuara nga trupat e saj, sipas propozimit të datës 14 janar 1920 të Konferencës së Paqes¹³.

Arsyerja e ndërhyrjes jugosllave në Mirditë duhet kërkuar edhe në rivalitetin midis Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene dhe Italisë për dominim në Shqipëri. Qeveria jugosllave nxiti këtë kryengritje, pikërisht në momentin kur çështja shqiptare pritej që t'i parashtrohej Këshillit Suprem të Fuqive Aleate dhe Shoqe¹⁴. Nxitja e lëvizjes kryengritëse në Mirditë ishte një mjet presioni nga ana e qeverisë jugosllave për balancimin e influencës në Shqipëri. Qeveria jugosllave synonte të shkaktonte një lëvizje antiitaliane në mesin e mirditorëve të besimit katolik. Ajo kërkonte me çdo mënyrë ta përfshinte qeverinë shqiptare në vorbullën e përplasjes së interesave midis shtetit serbo-kroato-sllloven dhe atij italian¹⁵. Ndërhyrja e saj lidhej me faktin se në këtë periudhë, Italia i kërkoj fuqive të tjera, të drejta speciale në Shqipëri dhe garanci për sigurinë e saj në Adriatik. Sapo drejtuesit e shtetit jugosllav kuptuan se nuk mund ta ndalonin Italinë me mjete të tjera, ata u kapën pas argumentit se meqenëse Italia kërkonte mbrojtjen e interesave të saj në Shqipëri, edhe shteti jugosllav kishte të drejtë të mbronte kufijtë e tij, përmes pushtimit të Shqipërisë së Veriut. Madje, qeveria jugosllave nxori në skenë parullën “Ballkani ballkanasve”¹⁶. Gazeta “Pravda” e Beogradit pohonte se në vitin 1915, mirditorët u treguan besnikë dhe i ndihmuan

¹³ TNA, FO 371/ 5728. Atasheu ushtarak britanik William Strang për markezin Curzon të Kedleston, Beograd, më 6 korrik 1921.

¹⁴ *Po aty*, FO 371/ 5728. Atasheu ushtarak britanik në ambasadën e Britanisë së Madhe në Itali për Sir George Buchanan, G.C.B., Romë, më 14 korrik 1921; *po aty*. Eyres për Earl Curzon të Kedleston, Durrës, më 25 korrik 1921.

¹⁵ *Po aty*, FO 371/ 5728. Harold Temperley, “Intervistë me Mid’hat Frashërin, kryetar i Delegacionit shqiptar”, Ambasada e Britanisë së Madhe, Paris, më 20 korrik 1921.

¹⁶ “The Albanian question”, në *Journal De Geneve*, First Edition, Saturday, August 6th, 1921.

serbët. Prandaj, edhe ky argument shtesë u përdor nga qeveria jugosllave që të mos qëndronte indiferente ndaj ngjarjeve në Mirditë¹⁷.

Këshilli i Lidhjes së Kombeve nuk mori në shqyrtim ankesën e qeverisë shqiptare që të detyronte qeveritë jugosllave dhe greke që të tërhiqnin trupat e tyre nga territori i Shqipërisë. Ai ia përcolli atë Komisionit të Ekspertëve në Konferencën e Ambasadorëve në Paris. Kjo zvarritje, nxiti qeverinë jugosllave që të përshkallëzonte ndërhyrjen e armatosur në Mirditë¹⁸. Për shkak të kryengritjes në Mirditë, qeveria e Iljaz Vrionit u detyrua të jepte dorëheqjen. Më 11 korrik 1921, u formua një qeveri koalicioni me përfaqësues të dy partive kryesore politike në vend, e drejtuar përsëri nga Iljaz Vrioni.

Më 16 korrik 1921, Marka Gjoni u tërhoq brenda territorit të shtetit jugosllav. Më 17 korrik 1921, Zyra jugosllave e shtypit njoftonte shpalljen e “Republikës së Mirditës” të Marka Gjonit në Prizren si dhe kërkohej njohja e saj zyrtare nga shtetet evropiane¹⁹. Një përfaqësi e shqiptarëve katolikë i kërkoi Lidhjes së Kombeve, përmes qeverisë jugosllave, shkëputjen e katolikëve të Shqipërisë nga sundimi i qeverisë së Tiranës, pasi të krishterët dhe myslimanët nuk mund të jetonin brenda një shteti²⁰. Shpallja e “Republikës së Mirditës” në krye të së cilës qëndronin disa mirditorë të arratisur, të kujtonte “qeverinë e Epirit Autonom” të vitit 1914. Por, ndryshe nga ajo, shumica e anëtarëve të kësaj qeverie me në krye Preng Bibë Dodën ishin analfabetë. Nga 18 mijë banorë që kishte Mirdita, vetëm tre burra dinin të shkruanin e të lexonin²¹. Marka Gjoni, i cili përfaqësonte interesat e “katolikëve të shtypur”, duhej të kërkonte njohje zyrtare nga një fuqi me popullsi katolike, por ai iu drejtua ministrave të Punëve të Jashtme të shtetit

¹⁷ TNA, FO 371/ 5725. Esktrakt i gazetës serbe *Pravda*, Beograd, 19 korrik 1921, bashkëlidhur raportit të William Strang për markezin Curzon të Kedleston, Beograd, më 21 korrik 1921.

¹⁸ AQSH, F. 151, V. 1921, D. 149, fl. 38-39. Fjala e Fan Nolit në Këshillin e Lidhjes së Kombeve, 25 qershor 1921; P. Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia...*, f. 131.

¹⁹ AQSH, F. 146, V. 1920, D. 35, fl. 20. Telegram i Marka Gjonit drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Beograd, Prizren, më 17 korrik 1920; J. Swire, *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie...*, f. 286; Kristo Dako, *Shënime historike nga jeta dhe veprat e NMT Zog i parë Mbret i Shqiptarëve*, Tiranë: Kristo Luarasi, 1937, f. 100.

²⁰ Gjergj Fishta, “Arsim, apo luftë kundra katoliqizmit në Shqypni (1923)”, në *Gjergj Fishta, Përmdritje: Analiza, polemika, kronika*, Tiranë: Lajmëtari 2000, 2000, f. 223.

²¹ TNA, FO 371/ 7328. Raport i Komisionit Hetimor të Lidhjes së Kombeve për punën e tij në Shqipëri nga 19 nëntori deri më 20 dhjetor 1921, Gjenevë, më 29 dhjetor 1921.

serbo-kroato-slloven dhe atij grek që kishin popullsi të besimit ortodoks²².

Prirja e Gjon Marka Gjoni për të siguruar njohjen nga Greqia ishte një lëvizje taktike që synonte dy objektiva të rëndësishëm: të siguronte mbështetjen e një shteti tjetër fqinj në Ballkan, krahas Serbisë; dhe të sintonizonte qëndrimin me qeverinë greke, duke akuzuar qeverinë shqiptare se ishte “qeveri myslimane” nën influencën e qeverisë turke të Azisë së Vogël dhe se merrte financime nga xhonturqit dhe bolshevikët. “Qeveria e Mirditës” akuzonte drejtuesit e qeverisë së Tiranës se ishin “vegla turke” dhe se oficerët myslimanë të ardhur nga Turqia synonin zgjatjen e trazirave në vend. Sipas udhëzimeve të qeverisë së Beogradit, ajo deklaronte se qeveria e Tiranës nuk ishte e vetmja në Shqipëri, pasi krahas saj, ekzistonte edhe qeveria e “Republikës së Mirditës”. Ajo akuzonte qeverinë shqiptare se kishte kryer masakra ndaj popullsisë së krishterë, kishte shkatërruar fshatra e shtëpi të tëra në Mirditë, me synim zhdukjen e të krishterëve²³. Me akuzat si qeveri “myslimane”, “xhonturke” dhe “bolshevike”, qeveria jugosllave dhe Gjon Marka Gjoni kishin si objektiv, nxitjen e reagimit të ashpër të qeverisë britanike ndaj qeverisë shqiptare.

Presioni ushtarak në veri dhe në jug të vendit i shtyu drejtuesit e qeverisë shqiptare të dyshonin për mundësinë e një aksioni të përbashkët ushtarak të shtetit serb dhe grek kundër Shqipërisë. Qeveria jugosllave mohoi ekzistencën e një marrëveshjeje të fshehtë serbo-greke si dhe i kërkoi qeverisë shqiptare që të dërgonte një mision në Beograd për të trajtuar këtë çështje. Qeveria shqiptare e hodhi poshtë këtë propozim, pasi misioni i Ali Riza Kolonjës sapo kishte përfunduar pa sukses. Nga ana tjetër, qeveria shqiptare druhej se serbët mund ta përdornin dërgimin e këtij misioni si argument në Konferencën e Ambasadorëve se gjoja çështja e kufijve po zgjidhej me marrëveshje midis dy qeverive. Kjo

²² *Po aty*, FO 371/ 5728. Telegram i Lord Granville për Foreign Office, Athinë, më 23 korrik 1921.

²³ *Po aty*, FO 371/ 5730. Telegram i qeverisë së “Republikës së Mirditës” drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë Serbo-Kroato-Sllovene, Prizren, më 22 gusht 1921; *po aty*, FO 371/ 5729. Ekstrakte gazetash serbe bashkëlidhur relacionit të W. Strang atashe ushtarak i legatës britanike, Beograd, më 1 shtator 1921.

mund ta arkivonte diskutimin e çështjes së kufijve të Shqipërisë nga Konferenca e Ambasadorëve dhe nga Lidhja e Kombeve²⁴.

Regjenti i princit të kurorës së Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, kërkonte zgjerimin e territorit të pushtimit në Shqipëri. Kjo kërkesë u kundërshtua nga Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë jugosllave, pasi depërtimi i ushtrisë jugosllave në thellësi të Shqipërisë, do të nxirrte mjaft probleme, mes të cilave më kryesori ishte furnizimi i ushtrisë jugosllave²⁵. Në fund të korrikut 1921, Marka Gjoni u rikthye në Mirditë i shoqëruar nga Osman Bali, Halit Lleshi dhe Taf Kaziu. Ai arriti të mblidhte rreth 1300 mbështetës. Qeveria jugosllave e mbështeti me një sasi të konsiderueshme municioni, me mitraloza dhe me dy topa malorë. Mid'hat Frashëri, kryetar i delegacionit shqiptar në Paris, raportonte në Lidhjen e Kombeve, se forcat serbe kishin hyrë brenda territorit të shtetit shqiptar, duke shkatërruar plotësisht apo pjesërisht 140 fshatra, 738 shqiptarë kishin humbur jetën, disa dhjetëra mijë krerë bagëti dhe një sasi e madhe misri ishte rrëmbyer, më tepër se 60 mijë shqiptarë ishin detyruar të largoheshin nga vendbanimet e tyre të shkatërruara dhe të gjenin strehë në brendësi të Shqipërisë.

Lëvizja kryengritëse e nxitur nga qeveria jugosllave, i shkaktoi mjaft probleme shtetit të dobët shqiptar. Ajo i krijoi qeverisë shqiptare vështirësi të mëdha për mbajtjen e një numri të madh refugjatësh. Krahas mundësisë së përhapjes së sëmundjeve të ndryshme, kriza humanitare rrezikonte të shkaktonte një përplasje midis autoriteteve shqiptare dhe refugjatëve në nevojë ose ndërmjet këtyre të fundit dhe popullsisë së Shqipërisë së Mesme. Qeveria shqiptare i kërkoi disa herë qeverisë serbo-kroato-slllovene tërheqjen e trupave të saj, por pa rezultat²⁶.

Më 25 korrik 1921, qeveria shqiptare dërgoi një forcë ushtarake prej afro 1200 vetësh për të shtypur kryengritjen në Mirditë nën komandën e gjeneralit Ali Riza Kolonja dhe të nënkolonel Ali Fehmi Kosturit. Marka Gjoni filloi sulmin ndaj trupave shqiptare dhe i shpalli luftë qeverisë shqiptare. Fillimisht, forcat kryengritëse patën një lloj avantazhi, por pas ardhjes së përforcimeve nga Tirana, trupat e qeverisë shqiptare arritën

²⁴ *Po aty*, FO 371/ 5728. Telegram i H. C. A. Eyres për Foreign Office, Durrës, më 1 korrik 1921.

²⁵ *Po aty*, FO 371/ 5728. Telegram i W. Strang për FO, Beograd, më 13 korrik 1921.

²⁶ *Po aty*, FO 371/ 5727. Memorandum i Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, Gjenevë, më 16 qershor 1921; *po aty*, FO 371/ 5728. Duka Atholl për Lord Curzon të Kedleston, datë 25 korrik 1921.

sukses në goditjen e forcave kryengritëse. Ato morën kontrollin e Oroshit, qendrës së Mirditës si dhe rrethuan këtë krahinë brenda një kohe të shkurtër. Trupat qeveritare dogjën shtëpinë e kapëdanit si dhe 60 shtëpi të kryengritësve të Mirditës. Në këto kushte, më 9 gusht 1921, Marka Gjoni u tërhoq në Bicaj të krahinës së Lumës, e cila gjendej nën kontrollin e forcave jugosllave²⁷. Shtypja e kryengritjes nga qeveria shqiptare tregoi qartë se, nëse qeveria jugosllave nuk do t'i jepte mbështetje të fortë Marka Gjoni, çështja e Mirditës do të ishte mbyllur nga qeveria shqiptare brenda një kohe të shkurtër.

Megjithëse intriga e organizuar prej shtetit jugosllav u thye nga forcat e qeverisë shqiptare, qeveria jugosllave nuk hoqi dorë. Ajo dislokoj forca të shumta në Has dhe Lumë, ndërkohë që trupat jugosllave arritën deri tek Ura e Vezirit në Kukës. Madje, Ali Riza Kolonja raportonte se forcat e tij ishin ndeshur me zjarrin e armëve dhe të mitralozave të një force ushtarake serbe, e cila kishte marshuar përtej lumit Drin deri në Qafën e Kumbullës. Për forcat shqiptare u krijua një moment i vështirë pasi një pjesë e tyre nuk pranuan të luftonin me shqiptarët që mbështeteshin nga jugosllavët. Në përbërje të këtyre forcave të drejtuara nga oficerë serbë, ishin edhe mjaft shqiptarë nga Prizreni. Forcat serbe i nxisnin banorët e krahinave të Lumës dhe të Dibërës që të godisnin trupat kufitare shqiptare dhe të shkaktonin incidente. Natyrisht, ishte e vështirë të besohej se oficerët serbë vepronin pa autorizimin e qeverisë jugosllave²⁸. Bajraktari i Lumës, i cili kundërshtoi të godiste forcat shqiptare, u burgos në Prizren, ndërsa banorët e kësaj krahine u kërcënuan se trupat serbe do t'u rrënonin shtëpitë dhe fshatrat e tyre²⁹.

Pjesa kryesore prej 1500 forcash qeveritare nën drejtimin e Ali Fehmi Kosturit, pasi morën Oroshin, lidhën besën me mirditorët për ruajtjen e paqes dhe lanë në Kodër Kolikë rreth 170 forca. Forcat ushtarake shqiptare u ndanë në tri pjesë: kolona e parë ushtarake, ndoqi drejtimin Shën Pal – Rrëshen; kolona e dytë, u nis në drejtim të Lurës; kolona e tretë ushtarake marshoi nga Mali i Shenjtë në Fan të Mirditës e

²⁷ *Po aty*, FO 371/ 5728. Telegram i W. Strang për FO, Beograd, më 23 korrik 1921; *po aty*, Telegram i H. C. Eyres për FO, Durrës, më 24 korrik 1921; *po aty*, FO 371/ 7328. Raport i Komisionit të Hetimit të Lidhjes së Kombeve mbi punën e saj në Shqipëri nga data 19 nëntor deri më 20 dhjetor 1921, Gjenevë, më 29 dhjetor 1921.

²⁸ *Po aty*, FO 371/ 5730. Raport i kapitenit Ali Riza i milicisë shqiptare bashkëlidhur relacionit të H. C. Eyres për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, më 8 shtator 1921.

²⁹ *Po aty*, FO 371/ 5728. Telegram i H. C. A. Eyres për FO, Durrës, më 28 korrik 1921.

deri në malin e Zhepës. Më pas, ato arritën deri në Aras në bregun e majtë të lumit Drin dhe i paralajmëruan forcat jugosllave që të tërhiqeshin në anën tjetër të lumit që të shmangej një luftë midis tyre³⁰. Shpërndarja e forcave në distanca të largëta, me një ndërlidhje të dobët logjistike e me mungesa në municione, ushqim dhe veshmbathje, ndikoi negativisht në mbarëvajtjen e operacionit ushtarak. Krahas mungesave të mësipërme, ndikim negativ pati edhe ndërhyrja e politikës në punët e ushtrisë³¹.

Pas shpërndarjes së forcave ushtarake shqiptare, forcat kryengritëse nën komandën e Preng Llesh Gjonit që mbante detyrën e ministrit të Luftës në të ashtuquajturën “Republikë e Mirditës” sulmuan garnizonin shqiptar në Orosh. Disa bajraktarë mirditorë shkelën besën, rrethuan Oroshin dhe filluan luftën kundër garnizonit shqiptar që gjendej aty. Kryengritësit i thyen forcat qeveritare, për shkak të numrit të pakët të tyre. Pasi ata u morën armët e rrobat ushtarëve, i lanë të lirë. Kjo ishte një goditje e rëndë për ushtrinë kombëtare shqiptare. Një forcë prej 600 vetësh e komanduar nga Shefqet Korça u nis nga Shkodra në drejtim të bajrakut të Dibrit, me synim rimarrjen e Oroshit. Ndërkohë, batalioni shëtitës i përbërë nga trupa të zgjedhura, i komanduar nga Preng Jaku, u dërgua si forcë mbështetëse, e cila rimori me shpejtësi Kodër Kolikën në Orosh. Trupat e Shefqet Korçës thyen shumicën e kontigjentit prej 1000 vetësh të forcave kryengritëse, që ishte përqendruar në zonën malore ndërmjet Vaut të Dejës dhe Gomsiqes. Ndërkohë, me urdhër të Ismail Haki Tatzatit, forcat vullnetare nga Shkodra të drejtuara nga Taip Lluja u nisën në drejtim të Munellës dhe arritën të merrnin nën kontroll të gjithë zonën. Fitorja e arritur nga forcat qeveritare kundër kryengritësve të vendosur në Vaun e Dejës, Gomsiqe dhe Munellë, pati një rëndësi të madhe strategjike, pasi në rast dështimi, kryengritësve u krijohej mundësia që të marshonin në drejtim të Lezhës dhe Shkodrës³².

Pasi zbrapsën trupat jugosllavë përtej lumit Drin, forcat e Ali Fehmiut u detyruan të riktheshin në Orosh. Luftimet vazhduan me ndërprerje gjatë gjithë kohës deri në fund të muajit nëntor 1921. Trupat jugosllavë armatosën me armë rreth 800 shqiptarë nga zonat që kishin nën kontroll dhe i detyruan që t’u bashkoheshin forcave të Marka Gjonit.

³⁰ *Po aty*, FO 371/ 5729. H. C. A. Eyres për Earl Curzon të Kedleston, Durrës, më 3 gusht 1921.

³¹ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 248.

³² *Po aty*, f. 249-250, 253.

Kësaj here vetëm tre bajraktarë të pjesës veriore të Mirditës iu përgjigjën thirrjes së tij. Në këto rrethana, ai u detyrua të tërhiqej në Prizren. Në fillim të gushtit, forcat e drejtuara nga Osman Bali, Halit Lleshi, Taf Kaziu si dhe oficerë jugosllavë në rezervë, bashkë me një sasi të konsiderueshme armatimi e municioni, kaluan brenda territorit të shtetit shqiptar³³. Gazeta gjysëmzyrtare serbe “Tribuna” shkruante, se kishte ardhur momenti i përshtatshëm për qeverinë jugosllave të pushtonte Shqipërinë e Veriut. Rreth 1200 deri në 2000 forca kryengritëse e trupa të rregullta serbe kaluan lumin Drin, morën Arasin, Muhrin dhe Lurën dhe marshuan në drejtim të Mirditës. Por, trupat shqiptare të ndihmuara edhe nga popullsia vendase kundërsulmuan dhe ia dolën që brenda 11 orëve të thyenin forcat sulmuese dhe t’i detyronin ato të tërhiqeshin përtej lumit Drin³⁴.

Qeveria e Tiranës gjendej në një pozitë të vështirë politike. Më 23 gusht të vitit 1921, qeveria e Iljaz Vrionit vendosi “ndalimin e botimit t’atyne gazetave që me artikullat e tyre shkaktojnë dasi midis popullit e elementeve të ndryshme ose prishin qetësin’ e vendit”³⁵. Me qëllim shmangien e një krize qeveritare, parlamenti vendosi mbylljen e punimeve të tij deri më 10 shtator 1921 dhe nëse nuk përmirësohej situata, drejtuesit e qeverisë mund të kërkonin shpërndarjen e parlamentit³⁶.

Gjendja në krahinën e Mirditës vijoi të mbetej e rëndë, për shkak të pranisë së bandave shqiptare të mbështetura nga forcat jugosllave. Një pjesë e kryengritësve, kur panë vendosmërinë e qeverisë shqiptare për të mbrojtur atdheun, vendosën të dorëzoheshin, por druheshin se do të vriteshin nga qeveria shqiptare. Zef Ndoci, një nga drejtuesit e kryengritjes, i bëri të ditur Ali Riza Kolonjës se pranonte t’i dorëzohej vetëm Elez Isufit të Dibrës³⁷. Ndërkaq, një pjesë e drejtuesve të kryengritjes vendosën të mos hiqnin dorë nga veprimet e tyre, për sa kohë

³³ *AQSH*, F. 151, V. 1921, D. 51, fl. 262. Telegram i ministrit të Punëve të Jashtme, Pandeli Evangjeli, për E. Drummond, datë 25 shtator 1921.

³⁴ *TNA*, FO 371/ 5730. Protestë e qeverisë shqiptare ndaj veprimeve të qeverisë serbo-kroate-slllovene në veri të Shqipërisë, Gjenevë, më 6 gusht 1921; *po aty*, FO 371/ 5729. H. C. A. Eyres për Earl Curzon të Kedleston, Durrës, më 13 gusht 1921.

³⁵ *Koha*, nr. 61, Korçë, 17 shtator 1921, f. 3.

³⁶ *Po aty*, FO 371/ 5729. Ekstrakte gazetash serbe bashkëlidhur relacionit të W. Strang, atashe ushtarak i legatës britanike, Beograd, më 1 shtator 1921.

³⁷ *Po aty*, FO 371/ 5730. H. C. A. Eyres për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, më 8 shtator 1921.

që ato paguheshin nga shteti serbo-kroato-sllloven. Mbështetësit kryesorë të Marka Gjonit merrnin tri napoleona ar në muaj dhe ky ishte një burim i mirë të ardhurash për ta. Qeveria shqiptare dispononte të dhëna se në mbështetje të Kryengritjes së Mirditës, qeveria jugosllave i kishte dhënë Marka Gjonit 1,5 milionë franga ari si dhe një sasi të konsiderueshme armësh dhe municioni. Kjo ndihmë i ishte dërguar atij përmes Francës³⁸.

Në gusht 1921, qeveria shqiptare i kërkoi Lidhjes së Kombeve të dërgonte në Shqipëri një komision për të parë në terren se cili ishte fajtor: shteti shqiptar apo Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene; të krijohej një komision arbitrazhi për të përcaktuar nëse vendimi i Këshillit të Lidhjes së Kombeve ishte zbatuar si dhe të njihej me situatën e përgjithshme në vend³⁹. Përfaqësuesi i Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene në Lidhjen e Kombeve, Slobodan Jovanović shprehej se “në të ashtuquajturën qeveri e Tiranës ka shumë pak shqiptarë” dhe se synimi i kësaj qeverie ishte t’u shërbente interesave turke⁴⁰. Përfaqësuesi shqiptar Fan Noli, u shpreh se shteti shqiptar ishte një model i harmonisë fetare ndërmjet myslimanëve dhe të krishterëve shqiptarë. Ai u përpoq të demontonte imazhin që ishte krijuar nga shtetet fqinjë, gjoja se shteti shqiptar ishte një “Turqi në miniaturë” dhe se të krishterët vriteshin e persekutoheshin nga shumica myslimane. Si dëshmi për këtë ai solli rastin e qarkut të Dibrës, ku shqiptarët myslimanë kishin nxjerrë si deputet të tyre një shqiptar të krishterë. Ai theksoi se nga 78 deputetë që kishte parlamenti shqiptar, 32 ishin të krishterë, ndër të cilët edhe kryetari i parlamentit.

Më 2 shtator 1921, Këshilli i Lidhjes së Kombeve vendosi që ankesa e qeverisë shqiptare ndaj shtetit jugosllav t’i kalonte Asamblesë së Lidhjes së Kombeve. Më 7 shtator 1921, kjo e fundit ngarkoi Komisionin e VI-të për ta shqyrtuar këtë ankesë. Në një rezolutë të miratuar më 2 tetor 1921, Asambleja e Lidhjes së Kombeve ngarkoi Këshillin për krijimin e një komisioni prej tre anëtarësh “të paanshëm”, me detyrën që të shkonte në Shqipëri për të mbikëqyrur zbatimin e vendimit të fuqive (kur të merrej vendimi) dhe për të hetuar mbi problemet e brendshme dhe

³⁸ *Po aty*, FO 371/ 5731. Telegram i Pandeli Evangjelit për Eric Drummond, Sekretar i Përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve, Tiranë, më 25 shtator 1921.

³⁹ “Fjala e Emzot Fan Nolit”, Kryetarit të Delegatës Shqiptare, mbajtur përpara Këshillit të Lidhjes së Kombeve me 25 qershor 1921”, në *Agimi*, nr. 4, Shkodër, gusht 1921, f. 73.

⁴⁰ *TNA*, FO 371/ 5730. Fjala e Jovanović, përfaqësuesit të Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, në Lidhjen e Kombeve, datë 2 shtator 1921.

në kufijtë e Shqipërisë, të cilat duhej t'ia raportonte Fuqive Aleate dhe Shoqe. Më 3 tetor 1921, Këshilli i Lidhjes së Kombeve vendosi që Komisioni hetimor të nisej pa vonesë për në Shqipëri⁴¹. Me argumentet e sakta dhe qëndrimin e urtë, Fan Noli arriti të fitonte simpatinë e përfaqësuesve të tjerë, kundrejt përfaqësuesit të Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, i cili “sillej pothuajse si i çmendur, duke krijuar një përshtypje shumë të keqe”⁴².

Pushtimi i territorit të Shqipërisë deri në lumin Drin ishte objektivimi minimal i qeverisë jugosllave. Me mbështetjen e saj në Aras u ngrit e ashtuquajtura “Republikë e Peshkopisë”, me drejtues Hasan Basriun dhe me mbështetjen e Halit Lleshit. Synimi i serbëve ishte të krijonte një enklavë autonome në krahinën e Dibrës. Kjo lëvizje kishte edhe karakter propagandistik, sepse synonte të krijonte përshtypjen te popullsia shqiptare se i gjithë territori i Shqipërisë së Veriut, i kishte kaluar Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene nga Fuqitë e Mëdha, por qeveria jugosllave dëshironte t'i plotësonte dëshirën popullsisë, duke krijuar një krahinë autonome⁴³.

Qeveria shqiptare ishte e shqetësuar nga mundësia e një sulmi të përbashkët serbo-grek. Greqia kishte vendosur pranë kufirit me Shqipërinë rreth 1200 trupa. Qeveria greke e hodhi poshtë idenë e një operacioni ushtarak në bashkëpunim me qeverinë jugosllave, pasi ajo do të nxiste qeverinë turke të mbështeste qeverinë shqiptare kundër saj. Meqenëse qeveria greke kishte përqendruar vëmendjen e saj në Azinë e Vogël, përparimi i trupave serbe në Shqipëri nuk shkonte në favor të interesave të saj⁴⁴. Gazeta serbe “Tribuna” shprehej se “asgjë nuk na bën të harrojmë se në jug është e ardhmja e shtetit tonë”. Madje, ajo kërcënonte se fuqitë që nuk kishin synime miqësore ndaj Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, duhej të merrnin “përgjigjen tonë kategorike”⁴⁵.

⁴¹ *Po aty*, FO 371/ 7329. Projekt i vëzhgimit historik të çështjes shqiptare hartuar nga një anëtar i Këshillit të Lidhjes së Kombeve, prill 1922.

⁴² *Po aty*, FO 371/ 5731. Memorandum i Harold Temperley mbi politikën shqiptare dhe serbe i dalë nga debatet në Gjenevë, FO, më 10 tetor 1921.

⁴³ *Po aty*, FO 371/ 5729. H. C. A. Eyres për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, më 31 gusht 1921; *po aty*, FO 371/ 5731. Konsulli H. C. A. Eyres për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, më 28 shtator 1921.

⁴⁴ *Po aty*, FO 371/ 5732. Telegram i Lord Granville për Foreign Office, Athinë, më 29 shtator 1921.

⁴⁵ *Po aty*, FO 371/ 5730. Ekstrakt i gazetës “Tribuna” të Beogradit bashkëlidhur relacionit të W. Strang për Foreign Office, Beograd, më 20 shtator 1921.

Në shtator 1921, një përfaqësi ndërkombëtare e përbërë nga komandanti zviceran Marconard, një përfaqësues i Kryqit të Kuq dhe ministri britanik Harry C. Eyres vizituan krahinat e prekura nga luftimet. Ata pohonin njëzëri se në të gjithë luginën e Drinit, nuk kishte tjetër veçse fshatra të djegura e të rrënuara dhe e gjithë lugina ishte e pabanuar. Pavarësisht se kjo krahinë nuk kishte provokuar luftën, aty kishte ndodhur një reprezalje mizore, pasi shqiptarët u përpoqën të mbroheshin nga sulmet dhe masakrat serbe. Eyres deklaronte, se pas kësaj vizite në terren, nuk kishte asnjë dyshim se të dhënat e paraqitura nga Komisioni i Hetimit të Lidhjes së Kombeve, për fshatrat e shkatërruara, ishin mjaft të sakta. Përpjekjet për mbrojtjen e vendit, detyruan qeverinë shqiptare të importonte një sasi të madhe municioni nga Italia. Fushata mbrojtëse dhe blerja e municioneve i kushtuan rëndë buxhetit të dobët të shtetit shqiptar⁴⁶.

Trupat e qeverisë shqiptare filluan të arrinin suksese në operacionet kundër forcave jugosllave në frontin lindor dhe në Kastrat të Shkodrës. Qeveria serbo-kroato-sllovene akuzoi trupat shqiptare se, gjoja gjatë operacioneve për shtypjen e Kryengritjes së Mirditës, ato përfituan nga rasti dhe sulmuan postat kufitare jugosllave brenda vijës së “demarkacionit Franche D’Esperay”. Komandanti i trupave jugosllave i paraqiti një ultimatum forcave shqiptare, se ato duhej të tërhiqeshin brenda 24 orëve nga Muhri, Arrasi, Sinaj, Gryka, Dardha dhe Mali i Lurës⁴⁷. Më 19 shtator 1921, trupat jugosllave me mbështetjen e artilerisë së rëndë kapërcyen lumin Drin dhe përparuan në drejtim të Lurës. Për shkak se forcat shqiptare ishin më të pakta në numër dhe në armatime, ato u detyruan të tërhiqeshin. Më 20-21 shtator, rreth një mijë trupa shqiptare u hodhën në kundërsulm. Pas luftimeve të ashpra, ku forcat pushtuese serbe përdorën edhe gaz helmues, këto të fundit u detyruan të tërhiqeshin, duke lëshuar të gjithë territorin që mbanin të pushtuar. Forcat jugosllave patën 57 ushtarë dhe katër oficerë të vvarë, një numër të madh të plagosurish si dhe dy oficerë mbetën robër⁴⁸. Qeveria e Beogradit justifikonte humbjet e saj me argumentin se Italia u kishte ofruar ndihma

⁴⁶ *Po aty*, FO 371/ 5731. Konsulli H. C. A. Eyres për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, më 28 shtator 1921.

⁴⁷ *Po aty*, FO 371/ 5731. Telegram i Pandeli Evangjelit për Eric Drummond, Sekretar i Përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve, Tiranë, më 18 shtator 1921.

⁴⁸ *Po aty*, FO 371/ 5731. Telegram i Pandeli Evangjelit për Eric Drummond, Sekretar i Përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve, Tiranë, më 25 shtator 1921.

të mëdha shqiptarëve, ndërsa në aspektin diplomatik Britania e Madhe ishte në krah të shqiptarëve⁴⁹.

Forcimi i pozitive të forcave shqiptare, shihej me shqetësim nga qeveria jugosllave. Ajo mendonte se tashmë qeverisë italiane i ishin krijuar rrethanat e përshtatshme për të ndërhyrë në Shqipëri, e cila duhej të shmangej me çdo lloj çmimi⁵⁰. Sulmet jugosllave ishin të vazhdueshme, të paprovokuara. Ato krijuan një paqëndrueshmëri politike në të gjithë Shqipërinë e Veriut. Në këto rrethana, qeveria shqiptare vendosi të vepronte në dy drejtime kryesore: t'i drejtohej për ndihmë Lidhjes së Kombeve dhe qeverive perëndimore ndaj këtij agresioni si dhe t'i kundërpërgjigjej me të gjithë fuqinë e saj sulmit të forcave serbe⁵¹. Ajo dërgoi Abdi bej Toptanin në Hungari, për të blerë municion për forcat shqiptare.

Më 22 shtator 1921, përfaqësues mirditorë dhe deputetë katolikë shqiptarë të mbledhur në një kuvend në Orosh i dërguan Lidhjes së Kombeve një telegram me 44 nënshkrime, në të cilin ata denonconin Marka Gjonin si "tradhtar", i cili për të kënaqur ambiciet e tij personale, kishte cenuar unitetin kombëtar të shqiptarëve, duke shpallur "Republikën e Mirditës" në një territor të huaj, me qëllim që t'i shërbente interesave të Serbisë. Ata deklaruan se ishin të gatshëm të sakrifikonin çdo gjë për mbrojtjen e pavarësisë dhe të integritetit të shtetit shqiptar dhe protestonin me forcë kundër ndërhyrjes së vazhdueshme të Serbisë në çështjet e brendshme të shqiptarëve⁵². Më 2 tetor 1921, Dom Zef Gjinali i telegrafoi Lidhjes së Kombeve, duke e denoncuar Anton Ashikun si "tradhtar", i cili ishte përjashtuar nga Urdhri Françeskan qysh në vitin 1920⁵³.

Qeveria shqiptare urdhëroi mobilizim të pjesshëm ushtarak dhe hartoi planin e një kundërsulmi ndaj forcave jugosllave që gjendeshin në brendësi të vendit, duke përqendruar një pjesë të mirë të forcave të saj në

⁴⁹ TNA, FO 371/ 5731. F. H. W. Stonehewer, zëvendëskonsull britanik në Shkup për Sir A. Young, ministër i Britanisë së Madhe në Beograd, Shkup, më 30 shtator 1921.

⁵⁰ Po aty, FO 371/ 5731. Memorandum i Kol. Liet. James M. Blair, ndihmësatashë ushtarak në legatën britanike në Beograd, datë 26 shtator 1921.

⁵¹ Po aty, FO 371/ 5731. Telegram i H. C. A. Eyres për Foreign Office, Durrës, më 29 shtator 1921.

⁵² Po aty, FO 371/ 5731. Telegram i bajraktarëve të Mirditës transmetuar Lidhjes së Kombeve përmes përfaqësisë shqiptare pranë Lidhjes së Kombeve, Orosh, më 26 shtator 1921.

⁵³ J. Swire, *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie...*, f. 290.

kufirin me shtetin jugosllav⁵⁴. Garnizoni shqiptar i vendosur në Rubik, nën komandën e Vas Kirit, i ngarkuar me detyrën e sigurimit të furnizimeve me municione dhe ushqimeve që transportoheshin nga Lezha në drejtim të Mirditës, u sulmua nga një forcë e madhe kryengritësish, nën drejtimin e bajraktarit të Manatisë. Pavarësisht epërsisë në numër, forcat qeveritare zhvilluan një rezistencë heroike, ndonëse për dy ditë mbetën pa ujë dhe ushqime. Pasi mori njoftimin, për gjendjen e rëndë në të cilën ndodhej garnizoni i Rubikut, forcat qeveritare nën komandën e Shefqet Korçës, u nisën nga Perlati dhe Proseku i Mirditës në drejtim të Rubikut dhe rrethuan forcat kryengritëse. Një numër i konsiderueshëm kryengritësish u zunë robër. Me urdhër të Sh. Korçës, bajraktari i Manatisë u pushkatua në vend, ndërsa robërit e tjerë u lanë të lirë⁵⁵.

Në Mbretërinë Serbo-Kroato-Sllovene nisi mobilizimi i afro 100 mijë trupave serbe⁵⁶. Në fund të tetorit 1921, qeveria jugosllave vendosi të ndërmerre përpjekjen e fundit për pushtimin e Shqipërisë së Veriut. Më 26 tetor, forcat jugosllave ndërmorën një sulm të ashpër ndaj Arasit, i cili ra në duart e tyre. Brenda një jave, forcat e qeverisë shqiptare u detyruan të tërhiqeshin nga Lura dhe Oroshi, të cilat ishin pozicione të rëndësishme ushtarake në Shqipërinë e Veriut. Forca të tjera jugosllave pushtuan Obotin, Shirokën si dhe dëbuan zyrtarët e doganës shqiptare në Shëngjin. Fushata e fundit e pushtimeve jugosllave, ndërpreu komunikimin e Tiranës me Oroshin, Lezhën dhe Shkodrën. Për shkak të pranisë së forcave jugosllave deri në afërsi të Lezhës, me mijëra shqiptarë u detyruan të zhvendoseshin në drejtim të maleve me dëborë ose përgjatë luginës së Matit. Sulmi në shkallë të gjerë dhe i paprovokuar si dhe arritja e trupave jugosllave rreth 60 km afër kryeqytetit të Shqipërisë, shkaktoi shqetësim të madh në radhët e qeverisë shqiptare. Tashmë, shteti shqiptar rrezikonte seriozisht që të humbiste pjesën e Shqipërisë së Veriut⁵⁷.

⁵⁴ TNA, FO 371/ 5731. W. Strang për Foreign Office, Beograd, më 1 tetor 1921; *po aty*. Telegram i Foreign Office për H. C. A. Eyres në Durrës, FO, më 3 tetor 1921; *po aty*, FO 371/ 5732. Telegram i H. C. A. Eyres për FO, Durrës, më 14 tetor 1921.

⁵⁵ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 251-252.

⁵⁶ TNA, FO 371/ 5731. Sir Alban Young për markezin Curzon të Kedleston, Beograd, më 6 tetor 1921; *po aty*. Sir A. Young për Foreign Office, Beograd, më 7 tetor 1921.

⁵⁷ *Po aty*, FO 371/ 5733. H. C. A. Eyres për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 30 tetor 1921; *Po aty*, FO 371/ 5732, Tel. i H. C. A. Eyres për Foreign Office, Durrës, më 31 tetor 1921.

Qeveria dhe populli shqiptar u tronditën nga agresioni jugosllav i ndërmarrë në shkallë të gjerë. Shpresa e tyre e vetme u përqendrua te fakti se çfarë do të vendosnin Fuqitë e Mëdha për të ardhmen e shtetit shqiptar. Veprimtaria agresive e shtetit jugosllav, i dha për të kuptuar diplomacisë perëndimore se aneksimi i territoreve të tjera shqiptare nga shteti jugosllav, do të shkaktonte shkatërrimin e mjaft zonave të banuara si dhe eksodin e popullsisë shqiptare. Madje, qeveria jugosllave do të shfrytëzonte këtë pozitë të privilegjuar për të kërcënuar Shkodrën dhe Tiranën, që të minonte ndikimin e qeverisë shqiptare. Për rrjedhojë, si rezultat i nxitjes së qeverisë jugosllave, anarkia do të vazhdonte në Shqipëri. Qeveria britanike e kuptoi qartë se luftimet me trupat jugosllave në territorin e shtetit shqiptar do të ndërpriteshin përmes ndërmarrjes së dy veprimeve: detyrimin e trupave serbe që të tërhiqeshin nga brendësia e shtetit shqiptar përpara fillimit të stinës së dimrit; si dhe kalimin e sovranitetit të zonave të pushtuara nga trupat jugosllave nën kontrollin e Fuqive të Mëdha, deri sa të përcaktohej përfundimisht vija kufitare midis dy shteteve⁵⁸.

Qeveria britanike vlerësoi se qeveria jugosllave synonte aneksimin e gjithë pjesës së Shqipërisë së Veriut. Ajo nuk do të rrezikonte humbjen e jetës së ushtarëve të saj dhe të kryente shpenzime të mëdha ushtarake, për të zënë përkohësisht vijën e demarkacionit, të cilën do të detyrohej ta dorëzonte disa ditë më vonë⁵⁹. Harold Nicolson propozoi që forcat jugosllave duhej të tërhiqeshin përtej linjës së demarkacionit para datës 7 nëntor 1921. Nëse qeveria serbo-kroato-slllovene nuk bindej për këtë akt, atëherë qeveria britanike duhej të hiqte dorë nga ideja e rektifikimit të kufijve të shtetit shqiptar të vitit 1913⁶⁰. Qeveria britanike i kërkoi Konferencës së Ambasadorëve që deri më 3 nëntor të merrte vendimin për caktimin e kufijve të shtetit shqiptar. Gjithashtu, insistoi që, në mënyrë urgjente, t'i dërgohej një paralajmërim Beogradit, ku t'i kërkohet me forcë, tërheqja sa më parë e forcave të saj nga brendësia e territorit të shtetit shqiptar⁶¹.

⁵⁸ *Po aty*, FO 371/ 5729. Telegram i FO për përfaqësuesin e saj në Lidhjen e Kombeve në Gjenevë, Londër, më 7 shtator 1921.

⁵⁹ *Po aty*, FO 371/ 5733. Kolonel Liet. James M. Blair, ndihmësatashë ushtarak në legatën britanike në Beograd, datë 2 nëntor 1921.

⁶⁰ *Po aty*, FO 371/ 5731. Shënim i H. Nicolson në protokollin e FO, datë 1 nëntor 1921.

⁶¹ *Po aty*, FO 371/ 5732. Telegram i FO për Lord Hardinge në Paris, FO, më 2 nëntor 1921.

Faktori kryesor që nxiti qeverinë britanike të ndërhynte në mbrojtje të shqiptarëve ishte lordi Robert Cecil. Ai kritikoi diplomacinë britanike se ishte treguar e paaftë për të përmbushur detyrimet e parashikuara nga Konventa e Lidhjes së Kombeve. Ai u shpreh se Britania e Madhe, si anëtare e Lidhjes së Kombeve, kishte “harruar” se sipas artikullit 16, “pushtimi i një vendi nga një shtet tjetër, përbën një akt luftime ndaj të gjithë anëtarëve të Lidhjes së Kombeve”. Ai paralajmëroi qeverinë britanike se “serbët në përgjithësi dhe N. Pashiç në veçanti, ishin një kërcënim i përhershëm për paqen në Evropë. Meqenëse ndodhen në mes të Ballkanit, ata mund t’i vinin zjarrin menjëherë këtij rajoni, të cilën e kanë bërë më se njëherë në të shkuarën”⁶². R. Cecil deklaroi prerë se qeveria britanike duhej të mbante parasysh se “serbët janë populli më barbar në Evropë dhe mund të kontrollohen vetëm përmes një veprimi shumë të ashpër”⁶³.

R. Cecil nxiti kryeministrin britanik të ndërmerre hapa në mbrojtje të shqiptarëve, sepse të dhënat që dispononte qeveria britanike konfirmonin plotësisht faktin se forca të mëdha serbe kishin pushtuar territorin e Shqipërisë përtej lumit Drin. Më 7 nëntor 1921, David Ll. George vendosi të njëjtte zyrtarisht qeverinë shqiptare. Në të njëjtën ditë, kryeministri britanik i dërgoi një telegram Eric Drummond, Sekretar i Përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve, në të cilin thuhej: “Meqenëse përparimi në vazhdim i forcave serbo-kroato-slllovene në Shqipëri ka një natyrë që trazon paqen ndërkombëtare, qeveria e Madhërisë së Tij...kërkon thirrjen e një mbledhjeje urgjente të Këshillit të Lidhjes së Kombeve, ku të shqyrtohej situata dhe të vendosej për masat që duhej të merreshin, sipas artikullit 16 të Konventës së Lidhjes së Kombeve”, për agresionin e ndërmarrë nga Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene ndaj Shqipërisë. Në të njëjtën kohë, kryeministri britanik kërkoi publikimin e vendimeve të marra nga Konferenca e Ambasadorëve për kufijtë e Shqipërisë⁶⁴.

Kjo ishte një fitore e rëndësishme e arritur nga shteti shqiptar, sepse ai tërhoqi simpatinë dhe mbështetjen e Britanisë së Madhe në një

⁶² *Po aty*, FO 371/ 5733. Lord Robert Cecil për kryeministrin britanik David Lloyd George, Londër, më 4 nëntor 1921.

⁶³ *Po aty*.

⁶⁴ *Po aty*, FO 371/ 5733. Telegram i kryeministrit britanik D. Lloyd George për Sir E. Drummond, Sekretar i Përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve, Gjenevë, më 7 nëntor 1921.

moment kritik për fatin e vendit, kur ishte vënë në rrezik pjesa e Shqipërisë së Veriut. Për shkak të agresionit të ndërmarrë ndaj Shqipërisë dhe nën presionin e Britanisë së Madhe, Mbretëria Serbo-Kroato-Sllovene ishte shteti i parë pas Luftës së Parë Botërore, që u vendos në bankën e të akuzuarve, për shkelje të Konventës së Lidhjes së Kombeve. Nga drejtuesit e Lidhjes së Kombeve, filluan të diskutoheshin sanksionet që duhej t'i vendoseshin këtij shteti⁶⁵. Lëvizja diplomatike e Fuqive të Mëdha i dha një goditje të fortë autoritetit që gëzonte shteti jugosllav në arenën ndërkombëtare⁶⁶. Me tone shoviniste, gazeta serbe "Pravda" shkruante se "tashmë ne jemi vendosur më poshtë se shqiptarët, përderisa gjendemi përpara gjykimit ndërkombëtar. Prandaj, të gjithë ata që na sollën në këtë katastrofë, duhet të mbajnë përgjegjësi". Ndërkaq, gazeta tjetër serbe "Epoka" shprehte habinë se "si ishte e mundur që N. Pashiç nuk arriti të shmangte një gabim kaq të madh, siç ishte dëmi moral, të cilin shqiptarët arritën të hedhin mbi ne". Ajo arrinte në përfundimin se qeveria serbe duhej "të mbante përgjegjësi për viktimat e pafajshme, sakrificat në këtë aventurë të panevojshme, për miliona dinarë të shpenzuara kot dhe për turpin që do të bjerë mbi kokën e Pashiç"⁶⁷. Qëndrimi i vendosur i Fuqive të Mëdha detyroi qeverinë jugosllave të fillonte tërheqjen e forcave jo të rregullta nga brendësia e Shqipërisë⁶⁸.

Në mbledhjen e Këshillit të Lidhjes së Kombeve të datës 16 nëntor 1921, u trajtua çështja e Kryengritjes së Mirditës. Mid'hat Frashëri, përfaqësuesi i Shqipërisë deklaroi se sulmi i padrejtë dhe i paprovokuar serb, i kushtoi buxhetit të shtetit shqiptar një shpenzim prej dy milionë franga ari, pa llogaritur shkatërrimet e pronës. Prandaj, në emër të qeverisë shqiptare, ai kërkoi dëmshpërblim nga shteti jugosllav. Përfaqësuesit jugosllavë, Mateja Boshkoviç (Bošković) Slobodan Jovanoviç dhe Tihomir Popoviç, mohuan akuzat se ushtria jugosllave kishte kaluar vijën strategjike. Madje, Boshkoviç u shpreh se trupat shqiptare ishin agresore dhe se trupat serbe kishin luftuar për të mbrojtur

⁶⁵ *Po aty*, FO 371/ 5733. G. S. Spicer i Zyrës së Kabinetit Britanik për Tufton [nuk ka datë].

⁶⁶ *Po aty*, FO 371/ 5733. Sir A. Young për Foreign Office, Beograd, më 11 nëntor 1921.

⁶⁷ *Po aty*, FO 371/ 5735. Ekstrakte gazetash serbe të përfshira në trupin e relacionit të Sir A. Young për markezin Curzon të Kedleston, Beograd, më 23 nëntor 1921.

⁶⁸ *Po aty*, FO 371/ 5733. Sir R. Granet për Foreign Office, Romë, më 10 nëntor 1921; *po aty*, FO 371/ 5735. Konferenca e Ambasadorëve për të Ngarkuarin me Punë të Mbretërisë Serbo-Kroato-Sllovene, Paris, më 18 nëntor 1921.

veten. Përfaqësuesi i qeverisë shqiptare, Mid'hat Frashëri, u kundërpërgjigj: “Shqetësimi i qeverisë serbo-kroate-slllovene për katolikët e Mirditës është i ri, pasi pak kohë më parë, shqetësimi i saj ishte shfaqur në favor të myslimanëve të qeverisë së Esad Pashës. Por, e vërteta ishte se shqetësimi i qeverisë jugosllave shfaqej për çdo tradhëtar të vendit tim”⁶⁹. Teza e politikës jugosllave se qeveria shqiptare nuk ishte e ligjshme ishte një përpjekje për të justifikuar veprimet e kryengritësve. Qëllimi ishte për të provokuar trazira brenda Shqipërisë, që të zvarritej sa më shumë vendimi për çështjen e kufijve të Shqipërisë, derisa kjo të shkonte në favor të serbëve. Madje, qeveria jugosllave ishte e gatshme të pranonte protektoratin italian nëse Italia do të pranonte kufirin verior dhe lindor të Shqipërisë, sipas propozimit të saj⁷⁰.

Krahas rrezikut të jashtëm, qeveria e Iljaz bej Vrionit akuzohej nga grupime politike brenda vendit, se ishte treguar e paaftë për të mbyllur konfliktin me shtetin jugosllav. Në fakt, sulmet politike ndaj qeverisë lidheshin me pakënaqësinë e një pjese të deputetëve të “Partisë Popullore” ndaj rritjes së ndikimit politik të Ahmet Zogut në vend⁷¹, si dhe me kërkesat e tepruara të disa përfaqësuesve të Kosovës. Mustafa Kruja ishte i pari që hodhi idenë e krijimit të “Bashkimit të Shenjtë”⁷². Grupi i “Bashkimit të Shenjtë” detyroi kryeministrin Iljaz bej Vrioni të jepte dorëheqjen. Një pleqësi e përbërë nga Bajram Curri, Avni Rustemi dhe Qazim Koculi u ngarkua nga dy palët, për të formuar qeverinë e re. Dy partitë kryesore politike në vend, vendosën që në qeveri të mos përfshiheshin Ahmet Zogu, Mustafa Kruja dhe Luigj Gurakuqi. Në këto rrethana, si drejtues i qeverisë u propozua Pandeli Evangjeli, i cili ishte nacionalist i ndershëm, por me një ndikim jo aq të madh në jetën politike të vendit. Qeveria përbëhej nga përfaqësues të dy partive kryesore politike të cilët nuk kishin përvojë në administratë⁷³.

⁶⁹ *Official Journal of the League of Nations*, Report of December 1921, pp. 1190-1191; “Nga Gjeneva. Korespondencë e posaçme”, në *Shqipëri' e Re*, nr. 58, Konstancë, 4 dhjetor 1921, f. 2; J. Swire, *Shqipëria. Ngrija e një mbretërie ...*, f. 298-299.

⁷⁰ TNA, FO 371/ 5731. Memorandum i Harold Temperley mbi politikën shqiptare dhe serbe, dalë nga debatet në Gjenevë, FO, më 10 tetor 1921.

⁷¹ “Rreziku i permrendshëm”, në *Hylli i Dritës*, nr. 1, Shkodër, maj 1921, f. 2.

⁷² Letër e Mustafa Krujës për Stavro Skëndin, Ramleh (Egjipt), 2 nëntor 1953, në *Hylli i Dritës*, nr. 3-4, Tiranë: 1996, f. 123-124.

⁷³ TNA, FO 371/ 5732. Telegram i H. C. A. Eyres për Foreign Office, Durrës, më 19 tetor 1921; “Reth dorëheqjes së Qeverisë”, në *Shqipëri' e Re*, nr. 53, Konstancë, më 6 nëntor 1921, f. 2.

Përpara qeverisë së P. Evangjelit qëndronte detyra e ngutshme e dëbimit të forcave jugosllave nga territori i Shqipërisë. Në fillim të nëntorit 1921, kryeministri Pandeli Evangjeli emëroi Ahmet Zogun komandant të operacioneve ushtarake në Mirditë. Ai i kërkoi Ahmet Zogut që të përdorte njëherësh politikën e forcës dhe të pajtimit, për zgjidhjen e çështjes së Mirditës. Caktimi i A. Zogut në krye të forcave ushtarake të vendit, shqetësoi kundërshtarët e tij politikë në Këshillin Kombëtar si dhe Aqif Pashë Elbasanin në Këshillin e Naltë⁷⁴. Qeveria miratoi propozimin e A. Zogut për arritjen e një marrëveshjeje paqësore prej katër pikash me popullsinë e krahinës së Mirditës përpara se të fillonte operacionin ushtarak me trupat e tij⁷⁵. Aqif Pashë Elbasani, anëtar i Këshillit të Naltë bindi regjentin tjetër monsinjor Luigj Bumçin, për t'i kërkuar dorëheqjen kryeministrit P. Evangjeli. Më 15 nëntor 1921, qeveria e Tiranës dërgoi përforcime në krahinën e Mirditës. Ajo nxiti forcat vullnetare nga krahinat e Shqipërisë së Mesme dhe Jugore të shkonin në Mirditë e në Mat për të mbrojtur vendin nga përparimi i trupave jugosllave. Më 20 nëntor, trupat e qeverisë shqiptare ndërморën një operacion ndaj forcave të Marka Gjonit, duke u shkaktuar atyre humbje të konsiderueshme.

Më 20 nëntor, Marka Gjoni lëshoi një shpallje me të cilën u kërkonte pasuesve të tij të ktheheshin në shtëpitë e tyre, ndërsa vetë, i shoqëruar nga 50 mbështetës kryesorë, u kthye në drejtim të Prizrenit. Pas mesit të muajit nëntor, Kryengritja e Mirditës praktikisht kishte përfunduar, por qeveria jugosllave qëllimisht vazhdonte të ndërmerre akte agresive për t'i mbajtur të tensionuara marrëdhëniet me qeverinë shqiptare. Ndërkohë, Anton Ashiku, i ashtuquajtur i përfaqësuesi i “qeverisë së Mirditës” në Beograd, pasi mori nga qeveria jugosllave rreth gjysëm milion dinarë shkoi në Prizren gjoja për t'ua shpërndarë këtë shumë refugjatëve mirditorë të arratisur⁷⁶.

Me ndërmjetësinë e Elez Isufit, qeveria shqiptare pranoi kërkesën e Gjon Marka Gjonit për të hyrë në negociata me të. Mirëpo, pa kaluar

⁷⁴ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, Periudha e Pavarësisë (28 nëntor 1912-7 prill 1939), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007, f. 181; Hysen Myshketa, *Kujtime e shënime pak edhe si historike*, përgatitën për botim prof. as. dr. Hysen Kordha, dr. Sali Hidri, Durrës: Acustica, 1999, f. 134.

⁷⁵ Hysen Kordha, “Ngjarjet e dhjetorit 1921”, në *Studime historike*, nr. 1, Tiranë: 1974, f. 53.

⁷⁶ TNA, FO 371/ 7326. Sir A. Young për Foreign Office, Beograd, më 19 janar 1922.

shumë kohë, qeveria shqiptare deklaroi se ajo i kishte ndërprerë këto negociata, pasi Marka Gjoni gjendej në Prizren dhe se qeveria jugosllave, e nxiste atë të paraqiste kërkesa të panegociueshme, që çonin në shkëputjen e Mirditës nga Shqipëria. Në mesin e qeverisë shqiptare pati dy rryma mendimi për këtë çështje: rryma e drejtuar nga kryeministri Pandeli Evangjeli dhe një pjesë e ministrave ishin të gatshëm të rifillonin bisedimet me Marka Gjonin; rryma tjetër, përbëhej nga pjesa tjetër e ministrave, të cilët ishin kundër negociatave me të. Sapo qeveria shqiptare u bind se Marka Gjoni nuk kishte pas vetes mbështetës, ajo vendosi të merrte kontrollin e Mirditës me anë të forcës ushtarake⁷⁷.

Çështja e Mirditës mbeti e hapur deri në fund të nëntorit 1921⁷⁸. Në fund të këtij muaji, trupat e qeverisë shqiptare të komanduara nga Ahmet Zogu hynë në Orosh pa asnjë incident dhe vendosën autoritetin e shtetit shqiptar në Mirditë. Më 28 nëntor 1921, qeveria shqiptare dekretoi një amnisti të përgjithshme. Më 2 dhjetor 1921, diplomati britanik Heathcote-Smith i gjendur në Orosh, raportonte se me përjashtim të 15 krerëve mirditorë që ishin larguar nga vendi, “pashë se pjesa e mbetur e parisë pranuan të dorëzoheshin tek Ahmet bej Mati”. Banorët e Mirditës u betuan se do të ishin besnikë ndaj qeverisë shqiptare, ndërsa kjo e fundit vendosi të ndiqte politikën e pajtimit kombëtar. Përfaqësuesi fuqiplotë i qeverisë, A. Zogu, shpalli një amnisti të përgjithshme në emër të qeverisë shqiptare për të gjithë ata që kishin kryer faje politike, me kushtin që ata të ktheheshin në shtëpitë e tyre brenda 45 ditësh; qeveria shqiptare vendosi që për tre muaj, të shpërndante falas një sasi misri për banorët e varfër të Mirditës, të prekur nga kriza e urisë; shtyrjen e afatit të pagimit të taksave për mirditorët; shpalljen e Kanunit të Maleve; si dhe kryerjen e shërbimit ushtarak për një periudhë tremujore në vend të 12 muajve⁷⁹.

Më 19 nëntor 1921, Komisioni Hetimor i Lidhjes së Kombeve arriti në Shqipëri. Anëtarët e Komisionit konstatuan se pozicionet e serbëve

⁷⁷ *Po aty*, FO 371/ 5735. Telegram i Heathcote Smith për FO, Durrës, më 12 nëntor 1921.

⁷⁸ *Po aty*, FO 371/ 5735. Letër e Prof. Anton Ashiku, ministër i Kulturës në qeverinë e “Republikës së Pavarur të Mirditës” për Sir A. Young në Beograd, Prizren, më 26 nëntor 1921.

⁷⁹ *Po aty*, FO 371/ 5735. Telegram i Heathcote C. Smith për FO, Durrës, më 8 dhjetor 1921; *po aty*, FO 371/ 5735. Heathcote C. Smith për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, më 9 dhjetor 1921.

ishin shumë afër Shkodrës. Në krahinën e Mirditës ishte vendosur qetësia. Gjatë kohës së zhvillimit të operacioneve të saj ushtarake, qeveria shqiptare arriti taktikisht të mbante Komisionin Hetimor të Lidhjes së Kombeve në Tiranë dhe Shkodër, me synim që ai të arrinte në Mirditë pasi të vendoste autoritetin e plotë në këtë krahinë⁸⁰. Më 10 dhjetor 1921, qeveria jugosllave u detyrua të tërhiqte trupat e saj nga territori i Shqipërisë⁸¹. Tërheqja e tyre i dha fund pushtimit më se trevjeçar të viseve veriore dhe krijoi mundësinë e bashkimit të tyre me shtetin shqiptar.

Ndërkohë që forcat qeveritare përpiqeshin të vendosnin qetësinë dhe autoritetin e shtetit shqiptar në krahinën e Mirditës, Aqif Pashë Elbasani nxiti kundër qeverisë grupin politik, që drejtohej nga Mustafa Kruja, Hasan Prishtina, Ramiz Daci, Irfan Ohri dhe Riza Dani. Ky grup kreu një grusht shteti, natën ndërmjet datës 6 dhe 7 dhjetor 1921. Ata hynë të armatosur në hotelin “Internacional”, ku rrinte kryeministri dhe përmes presionit, detyruan kryeministrin Pandeli Evangjeli të jepte dorëheqjen dhe formuan një qeveri tjetër nën drejtimin e Hasan Prishtinës⁸².

Në vështrimin e disa intelektualëve shqiptarë, shkaqet e Kryengritjes së Mirditës dhe përmbysja politike në Tiranë duhej të kërkohen te dobësitë e brendshme të shqiptarëve dhe veçanërisht të drejtuesve të qeverisë shqiptare. Ata mendonin se qeveria shqiptare duhej të kishte përdorur të gjitha mjetet paqësore për të shmangur “Lëvizjen e Mirditës”⁸³. Në fakt, burimet britanike dëshmojnë qartë se “Kryengritja e Mirditës” nuk filloi për shkak se autoritetet shqiptare cenuan sedrën e mirditorëve dhe të Marka Gjoni, por ajo u organizua dhe u mbështet kryekëput nga qeveria jugosllave⁸⁴. Ky mendim mbështetet në tre argumente kryesore: *së pari*, Marka Gjoni nuk kishte burime financiare për të organizuar një kryengritje të këtyre përmasave, prandaj ishte e qartë se ai merrte para nga jashtë dhe “nuk është e vështirë të vrasësh

⁸⁰ *Po aty*, FO 371/ 5735. Promemorie e Legatës serbo-kroato-sllavene, drejtuar Konferencës së Ambasadorëve në Paris, datë 6 dhjetor 1921.

⁸¹ *AQSH*, F. 151, V. 1921, D. 245, fl. 121. Telegram i Elez Isufit drejtuar Kryeministrisë, datë 10 dhjetor 1921.

⁸² *TNA*, FO 371/ 5735. Telegram i Heathcote-Smith për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, më 12 dhjetor 1921.

⁸³ M. Grameno, *Kryengritja Shqiptare ...*, f. 174.

⁸⁴ *Po aty*, FO 371/ 5726. Telegram i H. C. A. Eyres për Foreign Office, Durrës, më 13 maj 1921; *po aty*, FO 371/ 5727. H. C. Eyres për Earl Curzon të Kedleston, Durrës, më 16 qershor 1921.

mendjen se cili ishte burimi i financimit të tij”⁸⁵; *së dyti*, diplomatët britanikë në Shqipëri konstatonin se Kryengritja e Mirditës ndodhi krejt papritur dhe se një pjesë e mirditorëve dhe kleri katolik ishin kundër saj. Ata pohonin se, në fillim të vitit 1921, bajraktarët e Mirditës zhvilluan një takim me drejtues të qeverisë shqiptare në Tiranë, pas të cilit deklaruan se ishin mjaft të kënaqur me politikën e ndjekur prej saj. Ata u kthyen në vendlindje të gëzuar për pritjen në Tiranë dhe deri në fillim të muajit qershor 1921, në krahinën e Mirditës nuk ishte shfaqur asnjë shenjë trazire apo pakënaqësie ndaj qeverisë së Tiranës; *së treti*, fillimi i kryengritjes në Mirditë u shoqërua njëherësh me mbështetjen e ushtrisë jugosllave. Ushtria jugosllave marshoi në drejtim të rrethit të Gashit e të Krasniqes dhe zbriti deri në lumin Drin. Madje, raportohej se në mbështetje të veprimeve kryengritëse, njësi ushtarake jugosllave kishin depërtuar deri në Fan, një vend shumë pranë Oroshit. Gjon Marka Gjoni ishte këshilluar nga legata britanike që të ruante qetësinë, përderisa qeveria shqiptare nuk u kishte cenuar privilegjet mirditorëve dhe i kishte trajtuar ata me mjaft konsideratë. Mirëpo, përkundër këtyre këshillave, shprehej diplomati britanik, Marka Gjoni mendoi se pagesa prej 20 napolona ari në muaj, që merrte nga qeveria shqiptare ishte e pamjaftueshme. Prandaj, ai preferoi që të pasurohej me të holla që vinin nga jashtë, “duke e shitur veten shtrenjtë”⁸⁶.

Kryengritja e Mirditës ishte një lëvizje politike që shkonte kundër interesave kombëtare të shqiptarëve. Nga njëra anë, kryengritja e drejtuar nga Gjon Marka Gjoni i shkaktoi vuajtje të mëdha banorëve të krahinës së Mirditës, ndërsa nga ana tjetër, ajo e çoi shtetin shqiptar pothuajse në buzë të humnerës. Duhet theksuar se, qetësimi i situatës në Mirditë, ishte meritë e qeverisë shqiptare dhe veçanërisht e A. Zogut, i cili përmes politikës së pajtimit, ia doli me sukses, të bashkonte të gjithë Mirditën nën autoritetin e saj. Fitorja e qeverisë shqiptare në Mirditë, shkaktoi tension në qeverinë jugosllave, por më në fund, ajo kuptoi se “Karta e Mirditës” ishte djegur. Në këto rrethana, Anton Ashiku, një nga drejtuesit e eksperimentit të dështuar të “Republikës së Mirditës”, bëri përpjekjen e

⁸⁵ *Po aty*, FO 371/ 5728. H. C. A. Eyres për Earl Curzon të Kedleston, Durrës, më 7 korrik 1921.

⁸⁶ *Po aty*, FO 371/ 5728. H. C. A. Eyres për Earl Curzon të Kedleston, Durrës, më 7 korrik 1921; *po aty*, FO 371/ 5729. H. C. A. Eyres për Earl Curzon të Kedleston, Durrës, më 3 gusht 1921; *po aty*, FO 371/ 5730. H. C. A. Eyres për markezimin Curzon të Kedleston, Durrës, më 8 shtator 1921.

fundit. Ai i kërkoi Konferencës së Ambasadorëve që Komisioni Hetimor i Lidhjes së Kombeve, të takohej edhe me udhëheqësit e Mirditës në një vend të sigurtë⁸⁷.

Komisioni Hetimor i Lidhjes së Kombeve refuzoi të takohej me Marka Gjonin. Ai arriti në mendimin se ky i fundit nuk gëzonte popullaritet në Mirditë. Komisioni raportonte qartë se pas kryerjes së hetimeve të plota, anëtarët e tij, kishin bindjen se trazirat në këtë krahinë ishin ndërprerë plotësisht dhe çështja e Mirditës ishte zgjidhur përfundimisht. Prandaj, “çdo hamendësim për një qeveri të pavarur nën Marka Gjonin në Mirditë apo Prizren është absurde”⁸⁸. Më 17 dhjetor 1921, komisioni dërgoi një telegram nga Vlora, në të cilin thuhej se “çdo ide për një qeveri të pavarur të Mirditës është pa bazë dhe absurde, sepse askush nuk e pranon Marka Gjonin”⁸⁹. Në vjeshtë të vitit 1922, qeveria shqiptare ndërmoi edhe një hap tjetër në drejtim të forcimit të unitetit kombëtar. Ajo vendosi të shpallte amnistinë për Marka Gjonin dhe kryengritësit e tjerë mirditorë që gjendeshin të arratisur, si dhe dha leje që ata të riktheheshin në Shqipëri⁹⁰.

S u m m a r y

MIRDITA'S UPRISING OF 1921 AND THE ALBANIAN NATIONAL ISSUE UNDER THE OPTICS OF BRITISH DIPLOMACY

In this article, the author addresses the situation of Mirdita's Captain, Gjon Marka Gjoni, who remained dissatisfied with the Albanian government. Mirditor's disputes with the Albanian government were exploited by the

⁸⁷ *Po aty*, FO 371/ 5735. Letër e prof. Anton Ashiku drejtuar Konferencës së Ambasadorëve në Paris, Beograd, më 4 dhjetor 1921.

⁸⁸ *Po aty*, FO 371/ 7328. Raport i Komisionit Hetimor të Lidhjes së Kombeve për punën e tij në Shqipëri nga 19 nëntori deri më 20 dhjetor 1921, Gjenevë, më 29 dhjetor 1921; *po aty*, FO 371/ 7329. Raport i Komisionit Hetimor të Lidhjes së Kombeve mbi Shqipërinë i paraqitur para Këshillit të Lidhjes së Kombeve dhe i komunikuar nga Zyra e Kabinetit, datë 24 prill 1922.

⁸⁹ Edith Pierpont Stickney, *Shqipëria Jugore ose Epiri i Veriut në Çështjet Europiane Ndërkombëtare 1912-1913*, përkthyer nga Mal Berisha, Tiranë: Koha, 1998, f. 251-252.

⁹⁰ *TNA*, FO 371/ 7331. Raport përshkrues i komisionerit britanik Kol. Liet. J. Giles për ngjarjet e Komisionit të Caktimit të Kufijve nga data 3 nëntor deri më 11 dhjetor 1922, Beograd, datë 12 dhjetor 1922.

Yugoslav government. The Albanian government was disturbed by the determination of the Marka Gjoni to break its rules going to Prizren as well as for the “kindness” of the Yugoslav government to the Catholic Albanians. Leading a group of supporters, Marka Gjoni returned to Mirdita, in order to organize residents of this province against the Albanian government. The announcement of the “Republic of Mirdita” in Prizren, headed by some fugitive, recalled the “Autonomous Government of North Epirus” of 1914.

The British government estimated that it was clear that the Yugoslav government intended to annex the whole of northern Albania. The main factor that prompted the British government to intervene in defense of Albanians was Lord Robert Cecil. The call of the Nations League’s Council meeting by British Prime Minister David Ll. George to treat the aggression of the Serbo-Croatian-Slovenian Kingdom against Albania was an important victory achieved by the Albanian state. It gained the British government support at a critical moment for the country’s fate, and the Yugoslav state was brought in front of the international trial.

The military operation of the Albanian government for the suppression of the uprising did not succeed. In early November 1921, Prime Minister Pandeli Evangjeli appointed Ahmet Zogu as commander of military operations in Mirdita. At the end of this month, the Albanian government troops commanded by Ahmet Zogu entered Orosh and restored the authority of the Albanian state in Mirdita.

British diplomatic sources showed clearly that “Mirdita uprising” was organized and supported largely by the Yugoslav government. They point out that the British Legate in Albania advised Gjon Marka Gjoni to keep his peace, but he preferred to be rich with cash coming from abroad, “selling himself more expensive”.